



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.11.2021

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

RAPORT SHQYRTIMI NË PARIM

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 2.11.2021; 10.11.2021 dhe 11.11.2021, mori në shqyrtim në parim, projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2022”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Antoneta Dhima.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin të pranishëm Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie

II. Baza ligjore Kushtetuese.

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 155, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

III. Qëllimi, risitë dhe përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi dhe risitë

Projektbuxheti 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Paketa fiskale 2022, mbart të njëjtën frymë me Buxhetin e Shtetit 2022 dhe ka në fokus konsolidimin e financave publike, rritjen e të ardhurave të buxhetit dhe uljen graduale të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik.

Projektbuxheti 2022 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Vlerësimet më të fundit për rritjen ekonomike gjatë vitit 2021, kapin vlerën e 7.6 për qind, duke vijuar këtë trend pozitiv dhe në periudhën afatmesme 2022-2024 me një mesatare prej 4 për qind në vit.

Programimi i të ardhurave buxhetore mbështet synimet e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rimëkëmbjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet.

Gjithashtu opinioni i Bankës së Shqipërisë thekson së perspektiva e zhvillimit të vendit mbetet pozitive, dhe se rimëkëmbja ekonomike po vjen drejt konsolidimit. Për këtë arsye politikat tona ekonomike, ajo monetare dhe politika fiskale, duhet të fillojnë të orientohen gradualisht drejt normalizimit. Ky normalizim do të shërbejë përmirësimit të ekuilibrave makroekonomik, rritjes së hapësirës për përballimin e goditjeve potenciale në të ardhmen, si dhe forcimit të qëndrueshmërisë së financave të vendit. Në gjykimin tone sekuencimi optimal i këtij procesi normalizimi do të ishte konsolidimi fiskal i pasuar dhe i mbështetur nga tërheqja graduale e stimulit monetar në ekonomi. Kjo përjasje ofron mbështetjen e duhur për procesin e rimëkëmbjes dhe zbut rreziqet fiskale që burojnë prej rritjes së borxhit publik.

Konkretisht paketa fiskale përmban katër nisma ligjore:

1. *Projektligji “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*
2. *Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.*
3. *Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.*

4. *Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.*

Ndryshe nga 3 projektligjet e tjera të cilat bazohen në reduktimin e stimujve fiskale jo standartë dhe politikave jo efektive dhe eficientë, projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar propozon disa lehtësira në normat tatimore të tatimit të të ardhurave personale nga punësimi.

Ky propozim bazohet në Programin e Qeverisë dhe mbi parimin, se çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak tatime mbi të ardhurat nga paga, ndërsa kush fiton më shumë, do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët dhe gjithashtu mbështetet shtresa e mesme e popullsisë.

Kështu projektligji propozon:

- Rritjen e pagës dysheme të patatueshme pra me tatim zero %, për të ardhurat nga paga në intervalin nga 0 (zero) deri në 40,000 lekë/muaj, përkundrejt intervalit 0 (zero) deri 30 000 lekë/muaj që është aktualisht. Pra edhe tatimpaguesit me të ardhura personale nga punësimi në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj tashmë do të paguajnë 0% tatim, nga 13% tatim që paguanin mbi shumën 30,000 lekë/muaj, aktualisht.
- Reduktimin e normës tatimore me 50% për tatimpaguesit me të ardhura nga paga mbi 40,000 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj, duke paguar 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë të ardhura, dhe mbi këtë shumë do paguajnë gjysmën e normës tatimore prej 13% (pra $50\% * 13\%$ të shumës mbi 30 000 lekë).
- Mbështetet gjithashtu edhe shtresa e mesme, duke rishikuar fashën e sipërme të taksimit progresiv, kështu tatimi 23% parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht.

Përmbajtja

Projektligji përbëhet nga 2 nene, gjithsej si më poshtë vijon:

- Neni 1, të projektligjit, propozohet zëvendësimi i pasqyrës nr.1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, të ligjit, me tabelën e re sipas këtij projektligji
- Neni 2, i projektligji, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe fillimin e efekteve financiare duke filluar nga data 1 korrik 2022.

IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire

Ky projektligj nuk synon përafrimin me Acquis Communautaire

V. Efektet financiare të projektligjit

Projektligji, “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar parashikohet të sjellë një efekt negativ në buxhetin e shtetit në masën -1.37 miliardë lekë në vit.

VI. Konsultimi publik

Në kuadër të transparencës dhe me qëllim marrjen e opinioneve dhe komenteve nga grupet e interesit projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, është hedhur për konsultim publik në Platformën Elektronike të Konsultimit Publik, të ngritur në faqen web të Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk ka patur ndonjë koment lidhur me të.

Më datë 11.11.2021, gjatë seancës së votimit në parim të paketës fiskale dhe projekt Buxhetit 2022, pranë Komisionit të Ekonomisë u depozitua opinioni i Dhomës Amerikane të Tregtisë për paketën fiskale, e cila ndër të tjera kishte objeksione dhe propozime konkrete edhe për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar,, të cilat përmbledhtazi konsistojnë si më poshtë:

- Vendosija e tatimeve duhet të bazohet në disa parime që janë neutraliteti, efikasja, qartësia, thjeshtësia, efektiviteti dhe barazia. Asnjë nga këto parime nuk është ndjekur në projektligj.
- Skema e propozuar është tepër e komplikuar, krijon vështirësi në llogaritje, e paqartë dhe prodhon evazion, pasi krijon 3 intervale të ardhurash. Llogaritja në Shqipëri nuk është e automatizuar, çfarë sjell kosto të shtuar për bizneset me shumë punonjës.
- Skema thëllon pabarazinë ndërmjet tatimpaguesve, duke diskriminuar, pra tatuar vetëm tatimpaguesit me të ardhura nga pagat, krahasuar me tatimpaguesit e regjistruar si persona fizikë që mund të kenë të njëjtin nivel apo shumë herë më shumë të ardhura.

- Duke marrë në konsideratë dhe të ardhurat e tjera personale që kanë një natyrë pasive si dividendi, interesi, qiraja shohim një pabarazi të theksuar në shkallën tatimore krahasuar me pagat.
- Përrjashtimi që jepet për fashën e pagave deri në 40,000 lekë duhet të aplikohet në mënyre uniforme në të gjitha intervalet dhe të mos ketë diferencime. E paqartë është arsyeja dhe duket e padrejtë që niveli i tatimit prej 0% të mos jetë i zbatueshëm për të gjitha kategoritë njëlloj.
- Duke mbajtur parasysh që rritja e pragut të patatueshëm zakonisht shoqërohet dhe me rritje të pagës minimale në shkallë vendi për një kategori të madhe të punonjësve, tatimi i ri jep një efekt negativ nëse llogarisim nivelin e ri të sigurimeve shoqërore që nuk rimbursohet apo neutralizohet nga ndryshime të tjera ligjore.
- Fashat e reja nuk marrin parasysh të ardhurat me karakter sezonal.

Dhoma Amerikanë e Tregtisë, gjithashtu propozon si më poshtë:

- Të mos ketë progresivitet brenda fashave pasi kjo do të sillte shtrembërim të pagave reale me qëllimin për të mos kaluar në një fashë tjetër të tatimit.
- Nevojitet ndryshimi i metodës së tatimit të të ardhurave nga punësimi në baza vjetore dhe jo mujore. Tatimi mund të llogaritet dhe mbahet në baza mujore por është e detyrueshme që të bëhet dhe rregullimi në fund të vitit, përmes deklaratës vjetore.
- Tatimi në shkallën 6.5% të fillojë të aplikohet në mënyrë uniforme për intervalin e pagave 40,001 Lekë deri në një pagë deri në 100,000 Lekë në muaj dhe për pagat mbi 150,000 Lekë të taten me jo me shumë se 18%.

VII. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, bëri një prezantim të detajuar të Paketës Fiskale 2022, duke u ndalur në perspektivën makroekonomike të vendit për periudhën 2022-2025, në nivelin e realizimit të të ardhurave në përqindje përkundrejt Produktit të Brendshëm Bruto. Gjithashtu Ministrja dha një informacion specifik lidhur me nivelin e të ardhurave tatimore sipas llojit të tatimit të parashikuar për vitin 2022, si dhe mbi shpenzimet tatimore që përbëjnë edhe të ardhurat e munguara në Buxhet si rezultat i aplikimit të përrjashtimeve, dhe normave të reduktuara të taksimit.

Më pas Ministrja informoi komisionin lidhur me efektet e pritshme në të ardhura lidhur me paketën e re fiskale si dhe prezantoi përpara komisionit në mënyrë të detajuar propozimet e bëra në paketën fiskale 2022, për secilin projektligj dhe specifikisht edhe për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë shpjegoi përpara komisionit së në mënyrë që të lehtësohet barra tatimore e shtresave më në nevojë të popullsisë, është propozuar që tatimpaguesit me të ardhura personale nga punësimi në intervalin nga 30,001 lekë/muaj deri në 40,000 lekë/muaj tashmë të bëhet ë 0% tatim, nga 13% tatim që paguanin mbi shumën 30,000 lekë/muaj. Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga ulja e barrës tatimore është rreth 71,500 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 7,800 lekë për tatimpagues/vit ose rreth 557 milionë lekë/vit për të gjithë tatimpaguesit.

Në të njëjtën linjë, për lehtësimin e barrës tatimore të shtresave në nevojë të popullsisë, me anë të këtij projektligji propozohet që tatimpaguesit me të ardhura nga paga nga 40,001 lekë/muaj deri në 50,000 lekë/muaj, të vijojnë të paguajnë 0% tatim deri në shumën 30,000 lekë/muaj të ardhura nga paga, dhe ndryshe nga regjimi i mëparshëm, mbi shumën 30,000 lekë/muaj të paguajnë gjysmën e normës tatimore prej 13% ($13\% * 50\%$). Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga kjo lehtësi tatimore është rreth 58 000 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 11,700 lekë për tatimpagues/vit ose në total 678 000 000 lekë/vit për të gjithë tatimpaguesit.

Në kuadër të lehtësimit të shtresës së mesme të popullsisë, në këtë projektligj është parashikuar ndryshimi i fashës së sipërme të taksimit progresiv. Tatimi 23% parashikohet të fillojë të aplikohet në pagat mbi 200,000 lekë/muaj, nga 150,000 lekë/muaj që është aktualisht. Numri i tatimpaguesve që përfitojnë nga kjo lehtësi tatimore është rreth 5,900 dhe shuma e përfitimit është mesatarisht 23,000 lekë për tatimpagues/vit ose në total 135 000 000 lekë për të gjithë tatimpaguesit.

Relatorja së bashku me anëtarët e tjerë të mazhorancës, bënë prezent propozimet dhe risitë e bëra në këtë projektligj duke evidentuar se qëllimi i këtyre propozimeve është ofrimi i disa lehtësirave në normat tatimore të tatimit të të ardhurave personale nga punësimi, bazuar në parimin, se çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak tatime mbi të ardhurat nga paga, ndërsa kush fiton më shumë, do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët dhe gjithashtu mbështetet shtresa e mesme e popullsisë.

Anëtarët e komisionit, gjatë shqyrtimit në parim të projektligjit, kërkuan sqarime nga përfaqësuesit e qeverisë mbi mënyrën e përlogaritjes së formulës.

VIII. Përfundime

Për gjithë sa më lart u evidentua, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se projektligji pjesë e paketës fiskale që shoqëron projektbuxhetin 2022, është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe ka në fokus ofrimin e disa lehtësirave në normat tatimore të tatimit të të ardhurave personale nga punësimi, bazuar në parimin, se çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak tatime mbi të ardhurat nga paga, ndërsa kush fiton më shumë, do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët dhe gjithashtu mbështetet shtresa e mesme e popullsisë, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm të komisionit, e miratoi në parim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

RELATOR

Antoneta DHIMA

KRYETAR

Eduard SHALSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 22.11.2021

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

RAPORT
SHQYRTIMI NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË
28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 22.11.2021, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2022”.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 16.11.2021.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Antoneta Dhima.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin të pranishëm Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese.

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 155, të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

III. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pas miratimit në parim të tij në seancën plenare të datës 16 nëntor 2021.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit anëtarët e komisionit, patën në vëmendje edhe shqetësimet e grupeve të interesit, lidhur me projektligjin.

Anëtarët e komisionit diskutuan mbi parimin e ri (formulën) të përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat që vendos projektligji, përsa i përket progresivitetit dhe nivelit të pa taksueshëm së tatimit.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, u shpreh se incentiva ka për qëllim lehtësimin e barrës tatimore të shtresave më në nevojë të popullsisë. Projektligji bazohet mbi parimin, se çdo qytetar që siguron më pak të ardhura, do të paguajë më pak tatime mbi të ardhurat nga paga, ndërsa kush fiton më shumë, do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët.

Gjatë shqyrtimit të projektligji, anëtarët e komisionit në mënyrë të përsëritur ri ngritën shqetësimin lidhur me nevojën për një ligj të ri për tatimin mbi të ardhurat, i cili duhet të bazohet në 2 aspekte shumë të rëndësishme.

Aspekti i parë lidhet me atë që aktualisht ka filluar të zbatohet që është mbledhja e të gjitha të ardhurave nga puna dhe tatimi mbi bazën e shkallës progresive. Aspekti i dytë duhet të mbartë të njëjtën frymë edhe për të gjitha të ardhurat e tjera nga kapitali duke i bashkuar të ardhur nga të gjitha llojet e burimeve dhe tatuar më pas mbi bazën progresive.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, informoi komisionin se shumë shpjegimet e projektligji i ri për tatimin mbi të ardhurat do të vijë për shqyrtim në Kuvend.

IV. Përfundime

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me votat pro të shumicës së gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me ndryshimin e mëposhtëm:

- Neni 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998,“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pasqyra nr.1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, zëvendësohet me pasqyrën nr.1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi” , që i bashkëlidhet këtij ligji.”

RELATOR

KRYETAR

Antoneta DHIMA

Eduard SHALSI